



**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 75, datë 7.10.2016

**PËR**

**“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK TË TIRANËS NR. 58, DATË 30.12.2015, “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2016-2018 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2016( I NDRYSHUAR)”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “b”, pika 1/1.3, shkronja “c”, nenit 34, pika 6, nenit 40, pika 4, nenit 54, shkronja “dh” dhe nenit 55, pikat 3 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2016 për “Vetëqeverisjen Vendore”; nenit 113, të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 44, paragrafi i dytë, shkronja “a” të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2 datë 06.02.2012 për “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”(i ndryshuar); udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr.1 datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.58 datë 30.12.2015 për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016” (i ndryshuar); si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.58, datë 30.12.2015, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”( i ndryshuar) si më poshtë:
  - a- Shpërndarjen e Financimit për projekte të reja nga FZHR për vitin 2016 në programin “Zhvillimi i infrastrukturës vendore dhe rajonale” sipas pasqyrës nr.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Të miratojë detajimin dhe rishpërndarjen e fondeve të investimeve brenda Programit të Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik për vitin 2016, sipas pasqyrës nr. 2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Të miratojë rishpërndarjen e fondeve të investimeve brenda Programit të Shërbimeve Publike Vendore për vitin 2016, sipas pasqyrës nr. 3, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Të miratojë rishpërndarjen e fondeve të investimeve brenda Programit të Arsimit Parauniversitar dhe Edukimit për vitin 2016, sipas pasqyrës nr. 4, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
5. Të miratojë rishpërndarjen e fondeve të investimeve brenda Programit të Kujdesit Social për vitin 2016, sipas pasqyrës nr. 5, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

6. Të miratojë rishpërndarjen e fondeve të investimeve brenda Programit të Zhvillimit të Rinisë dhe Sportit për vitin 2016, sipas pasqyrës nr. 6, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
7. Të miratojë rishpërndarjen e fondeve të shpenzimeve brenda Programit të Kulturës dhe Turizmit për vitin 2016, sipas pasqyrës nr. 7, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
8. Të miratojë rishpërndarjen e fondeve për emergjencën civile për vitin 2016 duke pakësuar fondin rezervë sipas pasqyrës nr. 8, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
9. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit.
10. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**